



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602225/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda: Rekomandohet "Marrja e masave të menjëhershme për vizitën dhe trajtimin mjekësor në Spitalin Rajonal Lezhë, e të paraburgosurit N. Ç."

Drejtuar : Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale
"Shënkoll"
Z. Eduart KURTAJ

LEZHË

Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Miklovan KOPANI

TIRANË

I nderuar Z. KURTAJ,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit më datë 09.11.2016, ka paraqitur ankesë shtetasi N. Ç., i paraburgosur në IEVPenale "Shënkoll" Lezhë, i cili ka ngritur shqetësimin se, ka pesë muaj që ka bërë kërkesë për vizitë mjekësore në Spitalin Rajonal Lezhë, pasi ndjen dhimbje për arsye të dy operacioneve të kryera në mushkëri, dhe megjithatë nga ana e drejtorisë dhe personelit të Shërbimit Shëndetësor nuk është marrë asnjë masë për këtë qëllim.

Mbi këtë shqetësim më datë 14.11.2016, me shkresën nr. K2/N25-3, i kemi kërkuar informacion drejtorisë së IEVPenale "Shënkoll" Lezhë, por kemi konstatuar se nuk është kthyer përgjigje jo vetëm brënda afatit të caktuar në shkresën tonë, por edhe pse ka kaluar mbi një muaj.

Nga ana tjetër, Ndhimëskomisioneri i Avokatit të Popullit z. Petrit Azemaj, në disa raste dhe konkretisht, në datat 20.12.2016, 29.12.2016 dhe 09.01.2017, ka komunikuar me shefin e sektorit juridik në atë institucion, ku jemi informuar për faktin se përgjigja e shkresës tonë është vonuar për arsye të mungesës së mjekut, por është premtuar se ajo do të dërgohej sa më parë.

Në nenin 5 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”* i ndryshuar, i cili bën fjalë për Parimet Themelore, thuhet: *“Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre”*.

Kurse në nenin 33 të ligjit të mësipërm, i ndryshuar, i cili bën fjalë për Shërbimin Mjekësor, thuhet: *“Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve”*.

“Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë”.

Të drejtat e të dënuarve për trajtim në shërbimin shëndetësor parashikohen dhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Europës datë 12 Shkurt 1987, *“Për Rregullat Europiane të Burgut”*, ku në kapitullin që bën fjalë për Drejtimin e Sistemit të Burgjeve, Pikën 30.1 thuhet: *“Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të burgosurve dhe në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje, ose dëmtim dhe çdo të burgosuri t’i kushtohet një vëmëndje e veçantë”*.

Kurse në Pikën 32 të Rekomandimit të mësipërm thuhet: *“Shërbimet mjekësore të institucionit do të kërkojnë që të diagnostikojnë e kurojnë çdo sëmundje ose të metë fizike e mendore, që mund të pengojë riintegrimin e një të burgosuri pas lirit. Për këtë qëllim, të burgosurit do t’i sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psichiatrike, përfshirë ato që janë në dispozicion të komunitetit”*.

Për sa sipër duke gjetur se ankesa e shtetasit të paraburgosur N. Ç., është e drejtë, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirit”*,

REKOMANDOHE T

“Marrja e masave të menjëhershme për dhe trajtim mjekësor në Spitalin Rajonal Lezhë e të paraburgosurit N. Ç.”.

Analizën e rastit, me qëllim kthimin e përgjigjeve të shkresave “*Kërkesë për informacion*” të Instiucionit të Avokatit të Popullit, brënda afatit të kërkuar, dhe marrjen e masave që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI